



PËRMBAJTJE

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Besimi i publikut tek drejtësia është një nga vlerat më të çmuara që kultivohet në një shoqëri demokratike.

STORIE E SUKSESIT

Gjykata Themelore e Prizrenit së bashku me Prokurorin ligjëruan para studentëve të fakultetit juridik temën *“Korrupsioni”*.

LAJME

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

GJYKATA NË MEDIA

Komunikatat për media të Zyrës për Informim

INTERVISTË E SHKURTË

Nuredin Abazi – Gjyqtarë mbikëqyrës i Gjykatës Themelore të Prizrenit- dega në Suharekë

SI TI QASEMI GJYKATËS?

Si caktohen dhe ndahen lëndët?

A e dini se...?!

Kontakttoni Gjykatën Themelore të Prizrenit

GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i Gjykatës Themelore të Prizrenit
dhjetor 2017

Buletin informativ “Gjykatë e Hapur” * Nr. 9,
dhjetor 2017

Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit

www.gjygesori-rks.org



FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Të nderuar lexues,

Besimi i publikut tek drejtësia është një nga vlerat më të çmuara që kultivohet në një shoqëri demokratike.

Viti 2017 ishte vit i rezultateve konkrete të punës dhe hapjes së mëtejme të Gjykatës Themelore të Prizrenit ndaj qytetarëve. Jam i lumtur që bëjë pjesë në mesin e një ekipi të përkushtuar profesionistësh, të cilët janë dëshmia më e mirë e vullnetit të përkthyer në shërbime më të mira për qytetarët. Gjatë vitit 2017, Gjykata jonë i tejkaloi të gjitha parashikimet e punës, si në aspektin e trajtimit të lëndëve, po ashtu edhe në promovimin e standardeve të transparencës dhe llogaridhënies.

Përpjekje për avancimin e frymës së bashkëpunimit midis qytetarëve dhe gjykatës është edhe vazhdimi i publikimit të buletinit, ku sot para jush po e sjellim edhe numrin 9 të buletinit informativ “gjykatë e hapur” që ka bërë një hap pozitiv sa i përket informimit të qytetarëve me sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe punën e gjykatës në veçanti. Ky publikim periodik do të ofroj informacione për punën e gjykatës statistikisht e trajtimit të lëndëve, aktivitetet dhe projektet, qasjen e qytetarëve në gjykatë, përfshirjen e mediave dhe të tjera në shërbim të transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve.

Në emër të Gjykatës Themelore të Prizrenit dhe në emrin tim personal, u shpreh mirënjohjet e mia më të sinqerta të gjithë bashkëpunëtorëve nga shoqëria civile, media, Universiteti dhe segmente tjera të shoqërisë për gatishmërinë e tyre që të ndihmojnë në hapjen e mëtejme të gjykatës. Vetëm me punë profesionale e të paanshme, me trajtim të barabartë të të gjithëve dhe informim të saktë e të shpejt publik mund t'i arrijmë standardet e transparencës dhe llogaridhënies.

Gjykata Themelore e Prizrenit është gjykatë e hapur, e cila do të vazhdojë të investojë në forcimin e standardeve profesionale dhe të transparencës.

Ymer Hoxha

Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren

STORIE E SUKSESIT

Përfaqësuesit e drejtësisë dhe studentët e fakultetit juridik diskutuan temën e korrupsionit



Sot, më 15 nëntor 2017 në objektin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, Lëvizja “Fol” organizoj një diskutim të hapur në mes të përfaqësuesve të drejtësisë si dhe studentëve të këtij fakulteti, me theks të veçantë i kushtuan temës së korrupsionit.

Gjyqtari i Gjykatës Themelore të Prizrenit Skender Çoçaj sa i përket temës së korrupsionit ndër të tjera theksoi se : Korrupsioni është fenomen i vjetër dhe ka qenë i pranishëm pothuaj në të gjitha formacionet shoqëro-ekonomike. Me korrupsion rrezikohen themelet e funksionimit të shtetit ligjor. Ndikimi i korrupsionit është shumë i madh në institucionet shtetërore dhe në shoqëri sidomos në vendet në zhvillim dhe në vendet që kanë dalë nga lufta apo që janë në tranzicion, duke pasur parasysh mungesën e legjislacionit përkatës, vetëdijesimin e qytetarëve dhe faktorëve të tjerë, ndryshimin e shpeshtë të legjislacionit, kjo është duke ndodhur edhe në Kosovë, mirëpo edhe vendet me ekonomi të zhvilluar nuk janë imun ndaj këtij fenomeni, pra lirisht mund të themi se nuk ka vend ku nuk është i pranishëm korrupsioni.

Korrupsioni nuk është temë e re, ai vështrohet si një kërcënim i hapur për shoqërinë, ekonominë, administratën dhe rregullimin e një vendi me më shume se një mijë vjet .

Korrupsioni është një fenomen shumë kompleksë sa i përket zbulimit ndjekjes dhe të provuarit e tij, kjo për faktin se gjithmonë në korrupsion marrin pjesë dy palë dhe në shumicën e rasteve dy palët shpesh herë ndahen të kënaqura, asnjëri prej tyre nuk ka interes që të raportojë rastin, e kjo e vështirëson në masë të madhe zbulimin dhe ndjekjen e rasteve të korrupsionit.

Sikurse të gjitha vendet në tranzicion, ashtu edhe vendi ynë, ballafaqohet me ndërrimin e pronësisë që kryhet nëpërmjet privatizimit të pronës shtetërore dhe shoqërore dhe me tenderët për furnizimin e organeve shtetërore dhe kompanive publike me mallra dhe shërbime. Që të dyja këto sfera janë shumë të përshtatshme dhe ofrojnë mundësi potenciale për korrupsion.

Korrupsioni është fenomen i cili është preokupim i shumë shteteve pra është problem edhe ndërkombëtar.

Duhet të potencohet se ndjekja e veprave të korrupsionit është punë shumë e komplikuar për shkak se këto krime, sidomos krimet me natyrë të korrupsionit janë të fshehta, këto krime kryhen me mjeshtëri dhe nivel të lartë pasi që te këto vepra kryerësit e këtij krimi kanë aftësi të veçantë dhe tregojnë një profesionalizëm të madh duke fshehur gjurmë dhe duke vështirësuar organeve kompetente hetimin, zbulimin e tyre e po ashtu edhe qytetarët për arsye të ndryshme nuk dëshirojnë të bashkëpunojnë me këto organe.

Problemet në zbulimin e korrupsionit janë edhe informatat jo të mjaftueshme ose jo të plota për rastet e caktuara, në disa raste këto informata mbesin vetëm në dyshime që shpesh here duke mos pasur mundësi që të mbështeten edhe me prova konkrete e pamundësojnë zbulimin e veprave të korrupsionit.

Në gjykatën Themelore në Prizren i është dhënë prioritet absolut lëndëve që ndërlidhen me veprat e korrupsionit ashtu që të gjitha lëndët të cilat janë në këtë gjykatë janë duke u gjykuar, një numër i madh i këtyre lëndëve tani më janë kryer.

Promovimi i katalogut për të drejtat e viktimave të krimit në rajonin e Prizrenit



Me datë 08 shtator 2017, me mbështetjen e OSBE-së, u mbajt tryeza e rrumbullakët lidhur me promovimin e katalogut për të drejtat e viktimave të krimit, për rajonin e Prizrenit me qëllim të adresimit të hapave të ndryshëm procedural dhe fazave të ndryshme të ndihmës juridike viktimave.

Ky katalog ka për qëllim që të ofroj një hartë orientuese për viktimat e krimit nga rajoni i Prizrenit, me qëllim të sigurimit të drejtave të tyre, duke ju mundësuar qasje më të lehtë dhe më të kuptueshme rreth ekzistimit të mekanizmave ligjorë dhe institucionalë në dispozicion në fushën e të drejtave të viktimave të krimit. Katalogu është azhurnuar nga Forumi i Grave dhe Prokuroreve të Kosovës, dega në Prizren dhe është shtypur dhe publikuar nga ana e zyrës ligjore të OSB-së. Ky katalog është gjithashtu edhe produkt i disa punëtorive dhe publikimit të Katalogut për Këshilla dhe Ndihmë për Viktimat e Krimit të mbajtur në Gjilan në vitin 2016 në fushën e të drejtave të viktimave të krimit.

Katalogu do tu shpërndahet institucioneve që merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të viktimave në rajonin e Prizrenit (si Policisë së Kosovës, Prokurorisë, Gjykatave dhe degëve të tyre, Odës së Avokatëve, Mbrojtësve të Viktimave, Ndihmës Juridike Falas, Qendra për Punë Sociale, Ombudspersonit, Strehimoreve, dhe OJQ-ve), dhe do të shërbej si instrument për t'ua lehtësuar sadopak punën në ofrimin e shërbimeve për viktimat e krimit.

Forumi i Grave Gjyqtare dhe Prokurore të Kosovës është i bindur që ky katalog, do t'i shërbej viktimave të krimit në rajonin e Prizrenit që të rrisin njohuritë në lidhje me të drejtat e tyre dhe institucioneve përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për viktimat e krimit. Forumi është i vetëdijshëm që nga aspekti i të drejtave të viktimave, katalogu është një dokumentar me karakter gjithëpërfshirës, ndërsa sa i përket listës së institucioneve të dhëna në Aneks ka vetëm karakter rajonal. Në të ardhmen do të jetë një katalog për Këshilla dhe Ndihmë për Viktimat e Krimit për secilin rajon të Kosovës.

Në këtë takim morën pjesë: Shpresa Emra, Koordinatore e Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore të Kosovës në rajonin e Prizrenit, ligjëruese e këtij promovimi, Edije Sezairi, gjyqtare në lëmi civile për çështjet e dhunës në familje si dhe përfaqësues të zyrës ligjore të OSB-së ,përfaqësuesit e institucioneve dhe shoqërisë civile të gjitha komunave të rajonit të Prizrenit që merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të viktimave.



Me datën 14.09.2017, në orën 10:00 , Paqëruajtësit Zvicëran – Ekipet për ndërlidhje dhe Monitorim LMT të KFOR –it ,Capt (of-2) Cadosch Remo dhe S.Roost, me seli në Prizren, vizituan Gjykatën Themelore të Prizrenit me ç’rast u pritën nga zëdhënësja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja më për së afërmi me mbarëvajtjen e punës së kësaj gjykate, me seancat që procedohen në gjykatë, bashkëpunimin me institucionet e tjera të drejtësisë, transparencën e gjykatës, u njoftuan me punën e zyrës për informim publik, qasjen e qytetarëve brenda në gjykatë si dhe u pajisen me buletinin informativ “Gjykatë e Hapur” në të cilin përfshihen aktivitetet e gjykatës.



Me datën 24.10.2017, në orën 12:00 , Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan OJQ "Nevokoncepti" - Ansamble ja e fëmijëve të Komunës së Prizrenit.

Vizita kishte për qëllim njohjen më për së afërmi të punës që bënë kjo gjykatë dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme.

Ansamble ja e fëmijëve u vendosën në njërën nga sallat e gjykimit ku u pritën nga kryetari i Gjykatës Ymer Hoxha, zëdhënësja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj. Prezantimet fillestare u pasuan me diskutim me fëmijët dhe përfaqësuesve të gjykatës . Ndër të tjera u diskutua për të rehat që ka sjellë reformimi i sistemit gjyqësor, mundësit për takime direkt me kryetarin e Gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun.

Klaus Erdman këshilltarë në projektin e binjakëzimit të Akademisë së Drejtësisë së Gjermanisë dhe Akademisë së Drejtësisë së Kosovës së bashku me studentët e tij vizituan Gjykatën e Prizrenit



Me datën 25.10.2017 Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit Ymer Hoxha, priti në takim Klaus Erdman zyrtar ndërlidhës dhe këshilltar në projektin e binjakëzimit të Akademisë së Drejtësisë së Gjermanisë dhe Akademisë së Drejtësisë së Kosovës së bashku me disa studentë të tij, të cilët ndodhen në Kosovë për vizitë studimore.

Qëllimi i këtij takimi ishte njohja më për së afërmi me mbarëvajtjen e punës së kësaj gjykate, me të rehat që ka sjellë reformimin i sistemit gjyqësor, dhe me të arriturat dhe sfidat me të cilat ballafaqohet gjyqësori.

Në pjesën e dytë ata vizituan objektin e gjykatës sallat ku mbahen seancat gjyqësore, dhe si operojnë departamentet brenda gjykatës, u njohën me shërbime të tjera që ofron gjykata për qytetarët e Prizrenit.

Rëndësi të veçantë këtu takimi i kushtuan, zhvillimit dhe bashkpunimit të mëtutjeshme ndërmjet dy vendeve.

Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit priti në takim pune gjyqtarin e Gjykatës Themelore të Ferizajit, Agim Maliqin, Koordinatorin e KGJK, për lëndët që lidhen me natyrën korruptive



PRIZREN - 02.11.2017 – Sot Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit Ymer Hoxha priti në takim pune, gjyqtarin e Gjykatës Themelore të Ferizajit, z. Agim Maliqin, Koordinator i KGJK, për lëndët e shenjës truara në mekanizmin përcjellës dhe lëndët që lidhen me natyrën korruptive. Me Kryetari e kësaj Gjykate u dakorduan që lëndët e kësaj natyre të trajtohen me prioritet absolutë.

Nga 4 (katër) lëndë të cilat janë të shenjës truara në këtë gjykatë, prej tyre 2 (dy) janë të përfunduara kurse 2 (dy) të tjerat janë në fazën përfundimtare, përkatësisht në fjalën përfundimtare të palëve.

Gjyqtarët të cilët janë të angazhuar në këto lëndë të natyrës korruptive nuk paraqiten pengesë për kryerjen e këtyre lëndëve.

Përfundimi i këtyre lëndëve me prioritet dhe kohë është edhe njëri prej kushteve për Integrimin e Republikës së Kosovës në BE dhe liberalizim të vizave.

Nxënësit e shkollës së mesme të lartë “Ymer Prizreni” vizituan Gjykatën e Prizrenit



Me datën 03.11.2017 Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan nxënësit e shkollës së mesme të lartë “Ymer Prizreni” në Prizren të cilët iu krijua mundësia që ti vijnë orët e praktikës profesionale. Zëdhënësja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj i priti në një rën nga sallat e gjyimit ku prezantoi strukturën e gjykatës, punën që bënë gjykata, sfidat dhe bashkëpunimin e gjykatës me qytetarët, mënyrën e komunikimit me qytetarët , dhe mjetet e zhvilluara për krijimin e një lidhje më të mirë me publikun, si dhe iu krijua mundësia të marrin pjesë në një seancë gjyqësore. Gjykata edhe më tej do të vazhdon bashkëpunimin me qytetarët me shkollat e qytetit dhe të rajonit.

Përfaqësuesit e gjykatave, noterëve dhe regjistrit civil diskutuan mbi zbatimin e ligjeve në fushën e të drejtave të trashëgimisë



Data. 10.11.2017

Përfaqësuesit e gjykatave, noterëve dhe regjistrit civil komunal diskutuan dhe shkëmbyen praktikat më të mira nga këndvështrimi i institucioneve të tyre përkatëse mbi atë se si të adresojnë më së miri ndarjen gjinore në pronë dhe vështirësitë në zbatimin e ligjeve në fushën e të drejtave të trashëgimisë. Qëllimi i takimit ishte që të bashkohen përfaqësuesit e këtyre institucioneve të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e procedurave të trashëgimisë dhe ndikimin e tyre në të drejtat pronësore.

Përfaqësuesit Zviceran-Ekipet për Ndërlidhje dhe Monitorim ishin për vizitë në Gjykatën e Prizrenit



Me datën 13.11.2017, në orën 11:00 , Paqeruajtësit Zviceran – Ekipet për Ndërlidhje dhe Monitorim (LMT) të KFOR –it ,Spec of (OF - 2) Mauchle Benjamini dhe përkthyesi i ekipit me seli në Prizren, vizituan Gjykatën Themelore të Prizrenit me ç ‘rast u pritën nga zëdhënësja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantues me ekipin e ri për ndërlidhje me monitorim(LMT) pasi që ekipi ndërrohet çdo gjashtë muaj. Përfaqësuesit e rinjë të (LMT) u njohën më për së afërmi me mbarëvajtjen e punës së kësaj gjykate, me seancat që procedohen në gjykatë, bashkëpunimin me institucionet e tjera të drejtësisë, transparencën e gjykatës, u njoftuan me punën e zyrës për Informim Publik, si dhe qasjen e qytetarëve brenda në gjykatë.

Zyra Rajonale e OSBE-së, organizoi punëtori për të diskutuar për rolin e shoqërisë civile dhe mediave në përmirësimin e transparencës së gjykatave



Sot, më 15 nëntor 2017 në Prizren, Zyra Rajonale e OSBE-së organizoi një punëtori për të diskutuar rolin e shoqërisë civile dhe mediave në përmirësimin e transparencës së gjykatave. Në takim morën pjesë 27 pjesëmarrës, në mesin e të cilëve ishin të pranishëm Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, përfaqësues të Odës së Avokatëve dhe përfaqësues nga radhët e monitoruesve të sistemi të drejtësisë e të shoqërisë civile. OSBE-ja përmes kësaj ngjarjeje, filloi një diskutim rreth transparencës së Gjykatës Themelore të Prizrenit. Punëtorja mbledhi së bashku përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në rajonin e Prizrenit dhe media të cilët janë të përfshirë në monitorimin e gjykatave dhe raportimit në njërin anë, dhe përfaqësues të sistemit të drejtësisë, nga ana tjetër, duke përfshirë edhe gjyqtarët, prokurorët, zëdhënësen e Gjykatës Themelore, si dhe përfaqësues tjerë të komunitetit ligjor nga rajoni, për të diskutuar rolin e mediave dhe transparencën në rritje të gjykatës, praktikën më të mirë dhe raportimin kompetent dhe të saktë, si dhe sfidat dhe bashkëpunimin e ardhshëm në fushën e raportimit të gjykatës. Ngjarja organizohet në kuadër të aktiviteteve që kanë për qëllim përmirësimin e reagimit institucional për mbrojtjen e të drejtave të individëve, të drejtat për qasje në drejtësi dhe llogaridhënie të institucioneve të drejtësisë.

OSBE-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetjen e saj për përafrimin e mëtejshëm të praktikave gjyqësore me standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Qendra Rinore SHLK, i'u mundësoi të rinjëve të Rahovecit që ta vizitojnë Gjykatën Themelore të Prizrenit



Maturantet e Shkollës së mesme Profesionale qëndruan një ditë në Gjykatën Themelore të Prizrenit! Me qëllim të njohjes së punës së kësaj Gjykate, dhe funksionimit të saj, Qendra Rinore SHLK, i'u mundësoi të rinjëve të Rahovecit qëndrim një ditore në këtë Gjykatë. Të rinjtë u pritën nga kryetari i kësaj gjykate Ymer Hoxha, dhe zëdhënësjja e kësaj gjykate Aferdita Kicaj, të cilët të rinjtë ju treguan punën e kësaj gjykate, procedimin e lëndëve prej zyrës së pranimit e deri në përfundimin e saj. Kryetari i gjykatës ju premtojë maturantëve të kësaj shkolle se mund të vijnë në praktik dhe ti përcjellin seancat e kësaj gjykate të cilat janë të hapura për publikun. Qendra Rinore SHLK falenderon kryetarin e gjykatës z. Ymer Hoxha si dhe zëdhënësen znj Kicaj për një mundësi të tillë.

Studentët e Fakultetit Juridik, programi klinika juridiko-penale vizituan Gjykatn e Prizrenit



Me datën 14.12.2017, në orën 12:00 , Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan studentët e fakultetit juridik, programi klinika juridiko – penal të vitit të tretë dhe të katërt .

Vizita kishte për qëllim njohjen më për së afërmi të punës që bëjnë kjo gjykatë dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshëm.

Studentët u vendosen në njërin nga sallat e gjykimit ku u pritën nga gjyqtari për krime të rënda Skender Çoçaj, dhe zëdhënësja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj. Prezantimet fillestare u pasuan me diskutim me studentët dhe përfaqësuesit e gjykatës. Ndër të tjera u diskutua për të rejtat që ka sjellë reformimi i sistemit gjyqësor, mundësit për takime direkt me kryetarin e gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun. Në pjesën e dytë të vizitës, studentët vizituan objektin e gjykatës dhe u njohën me shërbimet që ofron ajo për qytetarët e Prizrenit dhe panë se ku dhe si operojnë departamentet brenda gjykatës.

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela e mëposhtme paraqet statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit për vitin 2017, si ato të trashëguara në fillim të vitit 2017, të ardhura, lëndët ne proces, lëndët që janë përfunduar në vitin 2017 dhe ato të mbetura në fund të vitit 2017. Statistikat e punës për vitin 2017 janë dëshmia e radhës numerike e përkushtimit maksimal të gjykatës për t'i shërbyer qytetarëve.

Tabela e statistikave

Gjykata Themelore - PRIZREN	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim te vitit 2017	Lëndët e ardhura gjatë 11-mujorit	Gjithsej lëndët në punë gjatë 11-mujorit	Lëndët e kryera gjatë 11-mujorit	Lëndët e mbetura në fund të 11-mujorit	Perqindja e lendeve te zgjidhura ne 11-mujorin
Dep.Për Krime Të Rënda	Penale	143	119	262	156	106	131,09
	Paraprake	214	119	333	127	206	106,72
Dep. I Përgjithshëm	Penale	3832	2221	6053	2340	3713	105,36
	Paraprake	669	550	1219	120	1099	21,82
	Civile	1204	1559	2763	1444	1319	92,62
	E.Civile	9257	1376	10633	3833	6800	278,56
	E.P. Me Burg	103	100	203	170	33	170,00
	E.P. Me Gjobë	999	501	1500	862	638	172,06
	Të Ndryshme	0	12712	12712	12712	0	100,00
	Trashegimore	35	83	118	87	31	104,82
	Jashtkontestimore	383	676	1059	520	539	76,92
	Dep. Për Të Mitur	Penale Para Kolegjit	218	115	333	92	241
Pregaditore		89	129	218	130	88	100,78
Divizioni I Kundërvajtjes	Kundërvajtje	5445	2728	8173	3587	4586	100,78
TOTALI		22591	22988	45579	26180	19399	113,89

GJYKATA NË MEDIA

Gjatë vitit 2017, periudha janar-nëntor - Zyra për Informim e Gjykatës Themelore të Prizrenit ka lëshuar rreth 84 komunikata për media, 223 aktgjykime të plotfuqishme të cilat janë publikuar në web.portalin e Gjykatës Themelore të Prizrenit www.gjyqesori-rks.org. Komunikatat kanë për qëllim të njoftojnë publikun mbi rastet e paraburgimeve dhe të shqiptimit të dënimeve si dhe për seancat që janë të hapura për publikun. Komunikatat për media të gjykatës janë paraqitur në të gjitha televizionet lokale në pothuaj të gjitha rastet.

Televizioni i Prizrenit, TV Opinioni, TV Besa, Prizren Press, Radio Kosova, Gazeta Zëri dhe Kallxo.com, kanë qenë mediat të cilat kanë përfshirë më së shumti kumtesat dhe ngjarjet e kësaj gjykate, njëherë shfrytëzojmë rastin ti falënderojmë për bashkëpunimin e tyre.

INTERVISTË E SHKURTË



Nuredin Abazi

Gjyqtarë mbikëqyrës në Gjykatën Themelore- Prizren - dega në Suharekë

1.Cilat janë sfidat me të mëdha me te cilat ballafaqohet dega e gjykatës në Suharekë?

Mungesa e stafit administrative me organo gramini e ri të aprovuar nga KGJK-ja, janë shkurtuar shumë vende pune e që në krahasim me numrin e lendeve si në divizionin e Kundërvajtjes po ashtu edhe në atë të përgjithshëm kemi mungesë të stafit administrativë edhe ata punëtor që janë, tre prej tyre janë jashtë procesit punës për shkak të paaftësisë për punë (sëmundjes) e që disa herë është bërë kërkesë Gjykatës Themelore në Prizren për zgjidhjen e këtij problemi që të njëjtit të dërgohen në komision për tu vërtetu aftësia e punës e që një gjë e tillë nuk ka ndodhë.

2.Sa janë të kënaqur qytetaret e Komunës së Suharekës, me shërbimet që i ofron Gjykata?

Në si staf i gjykatës në përgjithësi jemi duke e bërë të pamundurën që të plotësojmë kërkesat e

qytetarëve por një gjë e tillë është e pa mundur për shkak të vëllimit të madh të lëndëve si në Divizionin e Kundërvajtjes dhe atë të përgjithshëm, tani me emërimin edhe të dy gjyqtarëve në këtë degë mendoj se për një kohe relativisht të shkurtër pas fillimit të punës së tyre do të normalizohet situata por përsëri sfida mbetet ende mungesa e numrit të vogël të stafit administrativ.

3.A gëzojnë gjyqtarët si dhe stafi tjetër i gjykatës siguri të mjaftueshëm në kryerjen e punëve të tyre

Sa i përket sigurisë së stafit të gjykatës kjo është dukuri që i përcjellë të gjitha gjykatat në territorin e Republikës së Kosovës, siguri për gjyqtarët nuk ka fare dhe as që është duke u marr ndokush me këtë çështje të sigurisë nga nivelet e larta. Para vitit 2010 ka qenë stimulim për gjyqtarët si kundërvlerë për rrezikshmërinë e tyre në punë, tani edhe ajo nga viti 2010 është hequr.

4.A ka interesim nga qytetarët, studentët, apo nxënësit për pjesëmarrje në seancë gjyqësore të hapura për publikun?

Po kemi memorandum mirëkuptimi me shkollën e mesme profesionale “Avdyll Rama” në Suharekë –Shirokë të cilët sa herë kanë nevojë insistojnë në seancë kur ato janë të hapura për publikun po ashtu edhe qytetarët herë pas here asistojnë në seancat gjyqësore për të cilat shprehin interesim,

5.Sa bashkëpunoni me Organizatat e shoqërisë civile në Suharekë?

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile si në territorin e Komunës së Suharekës ashtu edhe jashtë, janë në nivel të duhur kërkesat e tyre preher ju plotësojmë me vullnetin me të madh duke i informuar të njëjtat me të arriturat dhe sfidat të procesit gjyqësor.

6.Shpesh raportohet për ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit? Çfarë mendoni ju për këtë?

Përfolët shumë për ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit, ndërsa sa i përket degës sonë, unë si udhëheqës i kësaj dege që nga viti 2010 e gjer më tani nuk ka ndodhë ndonjë ndërhyrje nga politika se paku për mua, por nuk kam informata që e njëjta të ketë ndodhur edhe tek gjyqtarët e tjerë.

7.Sa transparente është puna e gjykatës në Suharekë.

Sa i përket transparencës, Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë është mjaft transparente, të gjitha gjykimet kur ka vend në salla, mbahen në salla të gjykatës dhe sipas ligjit janë të hapura për publikun e gjerë.

8.A mund të na ilustroni praktikisht zbatimin e parimit të barazisë para ligjit në gjykatën tuaj?

Në gjykatën e Suharekës, parimi i barazisë para ligjit zbatohet në përpikëri, ashtu si e parashih ligji duke e përfshi angazhimin e avokatëve në rastet penale kur i pandehuri nuk ka mjete për angazhimin e avokatit, ndërsa në rastet civile udhëzohen palët që të angazhojnë avokat për mbrojtje nga shoqata të ndryshme kur plotësohen kushtet e parapara, po ashtu seanca gjyqësore zhvillohet gjithënjë në gjuhën që e kupton pala duke angazhuar përkthyes gjyqësor që parimi i barazisë para ligjit të aplikohet në tërësi.

SI T'I QASEMI GJYKATËS?

Si caktohen dhe ndahen lëndët?

Shpërndarja e lëndëve tek gjyqtarët bëhet me short. Të gjitha lëndët e pranura ndahen në grumbuj sipas numrit të gjyqtarëve dhe llojit të lëmisë juridike gjyqësore. Mbi çdo grumbull të lëndëve vihet një procesverbal në të cilin përshkruhet numri dhe lloji i lëndëve të cilat do të tërhiqen nga gjyqtari të cilit i bie shorti.



Ruajtja e konfidencialitetit

1. Të gjithë të punësuarit dhe të angazhuarit në gjykatë kanë për detyrë ta ruajnë sekretin zyrtar për të cilin kanë mësuar gjatë punës në gjykatë.
2. Sekret zyrtar konsiderohen të dhënat, informatat dhe dokumentet tjera jopublike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.



A e dini se...?!

LIGJI Nr.2004/26 Për trashëgimi, Neni 11

- Të gjithë personat fizikë në kushte të njejta janë të barabartë në trashëgimi. (LIGJI Nr.2004/26 Për trashëgimi, Neni 3, Paragrafi 1).
- Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllëzërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre.



KODI Nr. 03/L-193, LIGJI I DREJTËSISË PËR TË MITUR, Neni 27

Dërgimi në institucionin edukativ

1. Gjykata e shqipton masën e dërgimit në institucionin edukativ kur të miturit i nevojitet mbikëqyrje e plotë nga edukatorët adekuat dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të miturit.
2. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre (3) muaj apo më e gjatë se dy (2) vjet.





**Kontakttoni Gjykatën
themelore të Prizrenit**

Zyra e Administratës
Tel: +381 (0) 29/244 122
Adresa:

Gjykata Themelore
e Prizrenit
Rr. "Ibrahim Lutfiu",
p.n. Prizren, Kosovë



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU
PRIZREN TEMEL MAHKEMESI

BASIC COURT OF PRIZREN
Vizito:

www.gjyqesori-rks.org

Ky publikim është rezultat i Gjykatës të Prizrenit